



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E FINANCIVE DHE EKONOMISE
DREJTORIA E PERGJITHSHME E BUXHETIT

Nr. 3559 Prot.

Tiranë, më 20 / 02 / 2023

U D H E Z I M

NR. 4, DATE 20.2.2023.

**PËR PËRCAKTIMIN E KUFIRIT FINANCIAR TË VLERËS SË PLOTË TË PROJEKTIT NË
PËRPUTHJE ME SPECIFIKAT E SEKTORIT, MBI BAZËN E TË CILIT PËRCAKTOHET
MËNYRA DHE PROCEDURA E VLERËSIMIT TË PROJEKTIT TË INVESTIMIT PUBLIK**

Në përputhje me nenin 25 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, pikën 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 887, datë 27.12.2022 "Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike", Ministri i Financave dhe Ekonomisë,

U D H E Z O N :

1. Çdo propozim për projekt investimesh publike, që ka një vlerë të plotë mbi kufirin e përcaktuar sipas lidhjes Nr. 1, duhet t'i nënshtrohet një procesi të plotë vlerësimi, përpara fillimit të procesit buxhetor.
2. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në fletoren zyrtare.

MINISTËR

Delina IBRAHIMAJ



Kufijtë Financiar të vlerës së plotë të Projekteve

SEKTORI	PËRSHKRIMI	NËNSEKTORI	VLERA
Digjital	Infrastruktura Digjitale, i referohet teknologjive digjitale, të cilat ofrojnë bazën për teknologjinë dhe operacionet e informacionit të një njësie organizative. Do të konsiderohen si pjesë e Sektorit të Infrastrukturës Digjitale të gjitha projektet e investimit, rezultatet e të cilave synohet të kenë ndikim parësor në të paktën një prej nen-sektorëve të këtij sektori.	Ndërlidhja me Bazë të Gjerë	Mbi 500,000,000 Lekë
		Infrastruktura e-GOV	
		Sisteme informacioni	
		Platformat e Inovacionit	
Zhvillimi Ekonomik	Zhvillimi Ekonomik, i referohet programeve dhe politikave, apo aktiviteteve ekonomike, të cilat kanë për qëllim të përmirësojnë mirëqenien ekonomike dhe cilësinë e jetës së burrave dhe grave të komunitetit në vend. Do të konsiderohen si pjesë e Sektorit të Zhvillimit Ekonomik të gjitha projektet e investimit, rezultatet e të cilave synohet të kenë ndikim parësor në të paktën një prej nënsektorëve të këtij sektori.	Agrikultura	Mbi 500,000,000 Lekë
		Zhvillimi i Biznesit	
		Infrastruktura Bregdetare dhe Detare	
		Sipërmarrja	
		Industria	
		Zhvillimi Rajonal	
		Turizmi	
Energjia	Energjia, i referohet aktiviteteve ekonomike me impakt në prodhimin dhe shitjen e energjisë, përfshirë nxjerrjen e karburanteve, përpunimin dhe shpërndarjen e tyre. Do të konsiderohen si pjesë e Sektorit të Energjisë të gjitha projektet e investimit, rezultatet e të cilave synohet të kenë ndikim parësor në të paktën një prej nënsektorëve të këtij sektori.	Efienca e Energjisë	Mbi 1,000,000,000 Lekë
		Prodhimi I Energjisë	
		Transmetimi I Energjisë	
		Gazi	
		Nafta	
		Energjia e Rinovueshme	
Mjedisi	Mjedisi, i referohet aktiviteteve ekonomike të cilat kanë për qëllim mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin e burimeve natyrore. Do të konsiderohen si pjesë e Sektorit të Mjedisit të gjitha Projektet e Investimit, rezultatet e të cilave synohet të kenë ndikim parësor në të paktën një prej nënsektorëve të këtij sektori.	Menaxhimi I Fatkeqësive	Mbi 500,000,000 Lekë
		Mbrojtja nga Përmbytjet	
		Zhvillimi I Qëndrueshëm	
		Menaxhimi I Mbetjeve, Landfillet	
		Furnizimi me Ujë	
Social	Sektori Social, i referohet programeve dhe politikave, apo aktiviteteve ekonomike, të cilat kanë për qëllim reduktimin e shtrirjes së varfërisë dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës së burrave dhe grave të në vend si dhe adresimin e pabarazive gjinore në përgjithësi. Do të konsiderohen si pjesë e Sektorit Social të gjitha projektet e investimit, rezultatet e të cilave synohet të kenë ndikim parësor në të paktën një prej nënsektorëve të këtij sektori.	Kultura	Mbi 500,000,000 Lekë
		Edukimi dhe Sportet	
		Shëndetësia	
		Strehimi	
		Siguria e Brendshme	
		Drejtësia	
		Mbrojtja Sociale	
Transporti	Transporti, i referohet aktiviteteve ekonomike, të cilat kanë për qëllim zhvillimin apo përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese të transportit të mallrave dhe / ose qytetarëve nëpërmjet tokës, ujërave dhe ajrit. Do të konsiderohen si pjesë e të Transportit të gjitha projektet e investimit, rezultatet e të cilave synohet të kenë ndikim parësor në të paktën një prej nënsektorëve të këtij sektori.	Transporti Ajror	Mbi 2,000,000,000 Lekë
		Transporti në Ujërat e Brendshme, Portet	
		Transporti Hekurudhor	
		Transporti Rrugor	